

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sejko me drejtorët e bankave: Rritja e kredisë duhet të jetë e kujdesshme dhe e shëndetshme
ADRESA	https://www.cna.al/ekonomi/sejko-me-drejtoret-e-bankave-rritja-e-kredise-duhet-te-jete-e-kujdesshme-i474353
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 14:47:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 14:39:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0aa0b55db24fc34d63706d5559a57575102b24e3641f8c2fccccce68384eaae6
TEKSTI	ac245c74c9ca8fa60ac00ce4134075834eda30cc72dae3b83b61bab3176dde20
PAMJA	7b54d64186053e8b5f9e66fa7571faf3982e3479564a9fbe28b13d3c09d86102

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2897b1b3521c115c3e5682442faced430d8cdb6d7a30ddc02fdd15c69d90a350
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2897b1b3521c115c3e5682442faced430d8cdb6d7a30ddc02fdd15c69d90a350>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Sejko me drejtorët e bankave: Rritja e kredisë duhet të jetë e kujdesshme dhe e shëndetshme



16 Shtator 2026, 16:39, Ekonomi CNA



Gubernurit i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, zhvilloi sot një takim pune me drejtorët e përgjithshëm të bankave tregtare që operojnë në Shqipëri.

Në takim mori pjesë edhe Ministra e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj.

Sipas njoftimit zyrtar, takimi u zhvillua në kuadër të dialogut të vazhdueshëm të Bankës së Shqipërisë me sektorin bankar dhe u përqendrua në zhvillimet më të fundit në veprimtarinë bankare, ecurinë e kreditimit, tregun e pasurive të paluajtshme, si dhe në çështje me rëndësi për stabilitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit financiar.

Vëmendje e veçantë gjatë diskutimeve iu kushtua ecurisë së kreditimit dhe rolit të sektorit bankar në financimin e ekonomisë. Të dhënat tregojnë se kreditimi vijon të ruajë ritme të larta rritjeje. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, kredia për sektorin privat u rrit me 14.3% në terma vjetorë, ndërsa raporti i saj ndaj PBB-së arriti në rreth 35%, niveli më i lartë i regjistruar në dekadën e fundit. Rritja e kreditimit ka qenë e pranishme si në segmentin e bizneseve, ashtu edhe në atë të individëve.

Gubernurit Sejko vlerësoi se këto zhvillime krijojnë premisa që kreditimi të vijojë të mbështesë konsumin dhe investimet në ekonomi. Në të njëjtën kohë, ai theksoi rëndësinë që rritja e kredisë të vijojë në mënyrë të kujdesshme dhe të shëndetshme, duke ruajtur standarde të përshtatshme kreditimi dhe administrimi të rezikut.

Një tjetër çështje e diskutuar ishin edhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme dhe lidhja e tyre me aktivitetin kreditues. Diskutimet u fokusuan në ecurinë dhe dinamikën e këtij tregu, si dhe në zhvillimet e kreditimit për blerjen e banesave. Kredia hipotekare vijoi të shfaqë ritme të larta rritjeje, duke u zgjeruar me 16.1% në terma vjetorë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026. Ndërkohë, norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare në lekë qëndroi në nivelin 3.9%.


Në këtë kuadër, Gubernurit Sejko u ndal edhe në masat makroprudenciale të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për financimin e blerjeve në tregun e pasurive të paluajtshme, përmasat e vendosjes së kufijve të shtrembër për kreditë të cilat janë të paluajtshme rezidenciale, bazuar në raportet "kredi ndaj vlerës së pasurisë" dhe "shërbimi i borxhit ndaj të

përmasa rëndësishme se kurrë të operim për kreditimin për pesën të parafunduar rëndësishme, bazuar në raportet e kësaj lloji se përmasa e sistemit bankar naq të ardhurave". Guvernatori vlerësoi se masat e marra kanë dhënë efektet e pritshme, duke kontribuar në një kreditim më të kujdesshëm dhe të balancuar të tregut të banesave. Ai theksoi se këto masa mbështesin zhvillimin e shëndetshëm të kreditimit dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

Në takim u diskutua gjithashtu ecuria e Programit të Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm, të vënë në zbatim nga Banka e Shqipërisë për të përmirësuar aksesin në financim dhe për të ulur kostot e kredisë për këtë segment të rëndësishëm të ekonomisë. Nëpërmjet këtij programi, Banka e Shqipërisë ka vënë në dispozicion një fond prej 25 miliardë lekësh, i cili kanalizohet nëpërmjet bankave tregtare drejt bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe fermerëve. Programi krijon mundësi financimi me norma interesi të favorshme dhe është zgjatur deri në fund të vitit 2027. Deri më tani, në kuadër të këtij programi, Banka e Shqipërisë ka injektuar rreth 2.2 miliardë lekë likuiditet në sistemin bankar për financimin e bizneseve përfituese.

Guvernatori Sejko u bëri thirrje bankave tregtare që të angazhohen më aktivisht në zbatimin e programit dhe të risin kreditimin e bizneseve përfituese nëpërmjet tij, duke shfrytëzuar fondet dhe kushtet e favorshme që ai ofron. Ai theksoi se një përdorim më i gjerë i këtij instrumenti do të ndihmojë në përmirësimin e aksesit të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në financim, në mbështetjen e investimeve dhe në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë.

Në vijim, pjesëmarrësit diskutuan edhe çështje të lidhura me takimet e fundit të Misionit të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) në Shqipëri. Në këtë kuadër, u shkëmbyen vlerësime mbi çështjet e trajtuara gjatë misionit dhe angazhimin e sektorit bankar në këtë proces./ Monitor



Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

ABI Bank konsolidon rritjen në gjashtëmuajorin e parë 2026

Ujësjiellësit përmirësojnë financat, por 53% e shoqërive nuk mbulojnë kostot operative

Kursi i këmbimit, 16 shtator 2026

Nafta tërhiqet nga 108 dollarët, por mbetet mbi 105, tregjet druhen për furnizimet globale

Pagesat me kartë rriten, por kartat e kreditit nuk “ndezin” për shqiptarët

Një në katër të punësuar merr pagë minimale/ Rritet pesha e pagave më të larta

Kursi i këmbimit, 15 shtator 2026

Nafta në Shqipëri kushton 2.6 herë më shumë se mesatarja e gjithë Europës

Euro e nis edhe këtë javë në rënie, prek vlerën e 91.8 lekëve

Shqipëria mbetet pa masa fiskale për naftën/ Akti Normativ i akcizës nuk është më në fuqi

Ndryshime për monedhat e huaja/ Kursi i këmbimit valutor, 14 shtator

Taksat e Ramës mbysin çmimin e naftës/ Shqipëria, më e shtrenjta në rajon

Shqipëria, me kostot më të larta të prodhimit bujqësor në rajon

Pse i kemi çmimet kaq te shtrenjta? / TVSH e ushqimeve, nder me te lartat ne Europe

Kursi i këmbimit, 13 shtator 2026

Nafta kap rekorde rë reja, arrin 229 lekë, benzina 219 lekë për litër/ A rrezikohet furnizimi?!

Shqipëria: Bonusi erdhi, lindjet u tkurrën

Monedhat e huaja thellojnë rënien/ Kursi i këmbimit, 12 shtator 2026

Euro prek minimum të ri, thyen për herë të parë edhe pragun e 92 lekëve

Turizmi dhe remitancat e ulën deficitin e bilancit të pagesave në nivelin më të ulët prej vitit 2018

[editorial](#)

14:40 Editorial Elvi FUNDO

Hashim Thaçi e la Kosovën të lirë/ Erion Veliaj nuk ndahet nga karrigia që i dha PS-ja

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

13:25 Opinione Lutfi Dervishi

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.